

Donjeta Meta, na zbardhë fytyrën në mes të Berlinit

 Jan 07, 2015  04online  Shpreh Talentin 4 Comments **Lexuar 153**



Kosova është vendi i talenteve të dalluar. Njëra nga këto talente është Donjeta Meta, nxënësja shembullore e klasës së 12 në gjimnazin Loyola. Ajo u lindë me 24 korrik 1996 në Prizren. Është pjesë e një familje të dalluar në të gjitha aspektet. Ajo me shumë kujdes ndjek hapat e motrave dhe vëllait, ata së bashku bëjnë diferencën në mes nxënësve të dalluar dhe të edukuar të shkollës .

Në një aktivitet të organizuar nga “Deutsche Auslandsschulen “ (Shkollat gjermane jashtë vendit),

Donjeta Meta nga 5 deri në 7 janar 2015 ka përfaqësuar me shumë sukses jo vetëm shkollën dhe nxënësit e shkollës së saj, ajo me shumë krenari ka përfaqësuar Prizrenin dhe vet Kosovën.

Pjesëmarrësit në këtë manifestim konkurrues me shumë sukses kanë prezantuar aktivitetet në shkollat e tyre. Donjeta Meta me anë të një filmi të realizuar nga ajo në gjimnazin “Loyola”, ka prezantuar në mënyrë të shkëlqyeshme aktivitetin e nxënësve dhe arsimtarëve nga gjimnazi ku ajo ndjekë shkollimin.

Në këtë aktivitet në kryeqytetin gjerman, filmi prezantues i Donjetës për shkollën e saj, përkundër konkurrencës së madhe, ka fituar çmimin e dytë nga të gjithë pjesëmarrësit e shkollave gjermane. Por, kur këtij lajmi ia veçojmë të vërtetën, se Donjeta Meta ka përfaqësuar një shkollë, e cila shkollë është e vetmja shkollë jo gjermane, pjesëmarrëse në këtë konkurrencë, atëherë gëzimi për këtë sukses duhet ti tejkalojë muret e gjimnazit “Loyola” dhe këtij suksesi, përveç familjes, duhet ti gëzohemi të gjithë pa përjashtim .

Ky prezantim i Donjetës për gjimnazin “Loyola” në Gjermani është bashkë prodhim i saj me kolegu nga gjimnazi Loyola, Kenan Pallushi.

E institucionet e shtetit, asaj dhe të tjerëve si ajo, ti ofrojnë kujdes të shtuar, sepse investimi në një kapacitet intelektual si Donjeta Meta është pasuri shumë e madhe për kombin dhe shtetin.

Ne lutemi që Donjeta dhe Kenani ti kthehen shëndosh e mirë familjeve dhe shkollës së tyre./04online.info/